



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

SEKTORI MËSIMOR & KURRIKULËS, INFORMIMIT TË STUDENTËVE,
KËSHILLIMIT TË KARRIERËS DHE ALUMNI

Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë

Viti Akademik 2023 - 2024 / Kreu VIII		Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit
1.	Kreu VIII, pika 1 Kandidatët që kërkojnë të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve apo të ndjekin një program të dytë studimi me përjashtim të programeve të integruara të studimit, aplikojnë pranë IAL-ve, në datat e përcaktuara në kalendar.	Deri më 04.10.2023
2.	Kreu VIII, pika 11 Për programet që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruar nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët, në datat e përcaktuara në kalendar.	Deri më 06.10.2023
	Kreu VIII, pika 15 IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës së përcaktuar në kalendar.	Brenda datës: 06.10. 2023
3.	Kreu VIII, pika 16 Aplikimet për transferimin e studimeve dhe program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar në kalendar. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe faqet elektronike zyrtare përkatëse (web), e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr.5 të Udhëzimit Nr.12, dt. 30.06.2023.	Brenda datës: 10.10. 2023
4.	Kreu VIII, pika 17 IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat paraprake me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në kalendar. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.	Brenda datës: 11.10. 2023
5.	Kreu VIII, pika 19 IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar.	Brenda datës: 13.10. 2023
6.	Kreu VIII, pika 20 Regjistrimi i kandidiatit i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore në periudhën 16 – 20 Tetor 2023.	Në periudhën: 16 .10.2023 – 20.10.2023
7.	Kuotat e paplotësuara plotësohen nga kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe sipas datës së përcaktuar në kalendar.	Deri më 27.10.2023